



Prishtinë, 08 nëntor 2013

Kodi i ZRRE: V\_581\_2013

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
- Procedurën për lexim dhe faturim të konsumatorëve;
- Kërkesën e KKDFE-së të datës 25.09.2013, për fillimin e pilot projektit për leximin dhe faturimin e njehsorëve elektrik me pajisje të dorës (ang. Held Hand Unit "HHU") për distriktin e Ferizajt.

**në mbledhjen e mbajtur më datë 08 nëntor 2013 e nxori këtë:**

**VENDIM**

- I. **APROVOHET** kërkesa e Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KKDFE) për fillimin e pilot projektit për leximin dhe faturimin e njehsorëve elektrik me pajisje të dorës në distriktin e Ferizajt, duke filluar nga 01 janari i vitit 2014, me kusht që:
  - para fillimit të pilot projektit duhet të amandamentohet procedura e leximit dhe faturimit të konsumatorëve tariforë (përkohësisht për distriktin e Ferizajt);
- II. **Obligohet** KKDFE të bëjë informimin e konsumatorëve në Distriktin e Ferizajt për fillimin e zbatimit të këtij pilot projekti, gjatë shpërndarjes së faturave të muajit nëntor të vitit 2013.
- III. **Obligohet** KKDFE të dërgojë rezultatet e një cikli të leximit, brenda 15 ditësh pas përfundimit të atij cikli të leximit, si dhe zgjidhjen për balancën vjetore (të realizuar) të energjisë elektrike, ndërsa Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), pas vlerësimit të rezultateve, do të marr vendim lidhur me zbatimin e projektit në të gjitha distriktet brenda territorit të Republikës së Kosovës.

**Arsyetim**

- o ZRRE me datë 25.09.2013 ka pranuar nga KKDFE kërkesën për fillimin e pilot projektit për leximin dhe faturimin e njehsorëve elektrik me pajisje të dorës në distriktin e Ferizajt, duke zgatur kohën e leximit të njehsorëve nga 4 - 5 ditë sa është e përcaktuar në procedurën aktuale në 20 - 22 ditë pune, që do të thotë leximi do të bëhet gjatë tërë muajit.
- o ZRRE gjatë kësaj periudhe ka pranuar dokumente përkatëse nga KKDFE, dhe janë zhvilluar edhe takime të përbashkëta, dhe pas vlerësimit të këtyre dokumenteve përkatëse, është vendosur si në dispozitivin të këtij vendimi.
- o ZRRE konsideron se me realizimin e këtij projekti do të përmirësohet mënyra e leximit dhe faturimit të konsumatorëve, do të rritet përgjegjësia e lexuesve, do të zvogëlohet mundësia e



gabimeve në faturim, po ashtu faturat do t'iu shpërndahen konsumatorëve në momentin e leximit.

- o Me këtë metodë duhet që lexuesit të specializohen vetëm për lexim dhe faturim dhe këtë aktivitet do të kryejnë gjatë tërë muajit, ndërsa punëtorët tjerë të cilët e kanë kryer këtë detyrë do të specializohen për aktivitete tjera, si: kontrollimin e njehsorëve, evitimin e defekteve dhe manipulimeve me njehsor, shkyçjet/rikyçjet etj.
- IV.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- V.** Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE**

---

Enver Halimi, Kryesues

---

Përparim Kabashi, Anëtar

---

Blerim Koci, Anëtar

---

Merita Kostari, Anëtare

---

Krenar Bujupi, Anëtar